

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-081/13

Prishtinë,
20 Nëntor 2014

Në çështjen juridike të:

E. R.

Komuna e Shtimes

Pala ankuese

Kundër

V. S.

Kragujevc
Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Ertezi dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2011 i datës 26 tetor 2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA40111), pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Nëntor, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/DA/126/2011 për sa i përket kërkesës me numrin KPA40111.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale:

1. Më 20 qershor 2007 pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e tokës në Gracko afër Bujoncit, në Kraishtë, Komuna e Lipjanit, zona kadastrale Kraishtë, numër 1195, me sipërfaqe prej 50 ari 63 m² (prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar me nr. KPA40111.
2. Asnjë person nuk e ka informuar AKP-në për qëllimet e tij/saj në pjesëmarrjen në procedurë administrative.
3. Më 19 dhjetor 2008 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ka vendosur për kërkesën (Vendimi grupor KPCC/D/A/29/2008; tani e tutje: vendimi i parë i KKPK-së).
4. Më 8 mars 2010, KKPK-ja ka vendosur që vendimi i datës 19 dhjetor 2008 të anulohet, pasi që kërkesa nuk është proceduar siç duhet. Nuk është bërë identifikimi fizik i pronës së kërkuar po ashtu edhe nuk është bërë njoftimi i duhur i saj.
5. AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës përmes publikimit në Gazetën për Njoftime të AKP-së, nr. 5 dhe në Buletinin e zyrës për prona e UNHCR-it. Gazeta i është dorëzuar kryetarit të fshatit.
6. Përsëri asnjë person nuk e ka informuar AKP-në për qëllimet e tij/saj në pjesëmarrjen në procedurë administrative.
7. KKPK-ja ka vendosur më 26 tetor 2011 (vendimi grupor KPCC/D/A/126/2011; tani e tutje: vendimi i KKPK-së) se pala përgjegjëse e ka vërtetuar se V. S. është pronare e 1/1 së pronës së kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë gëzon të drejtën e posedimit të pronës së kërkuar.
8. Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 2 prill 2012.

9. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së në AKP më 5 prill 2013.
10. AKP-ja ka dërguar një kopje të ankesës te pala përgjegjëse në ankesë, por ai nuk ka kthyer përgjigje.
11. Përmes urdhrit të gjykatës të datës 14 nëntor 2013, pala ankuese është urdhëruar të deklarojë:
 - a. Arsye se pse nuk ka marr pjesë në procedurë pranë KKPK-së,
 - b. Kur dhe si e ka pranuar informatën rreth vendimit të KKPK-së dhe të dyja palët janë urdhëruar si vijon:
 - c. Sigurimin e provave lidhur me pronësinë dhe/ose posedimin e pronës së kërkuar,
 - d. Dhënien e informatave të detajuara rreth posedimit, shfrytëzimit dhe humbjes së pronës së kërkuar gjatë konfliktit të armatosur ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 (tani e tutje: lufta).

Përmbledhja e çështjeve faktike

12. Pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar bashkë me kërkesën një ‘ Kopje të fletës poseduese nr. 100 nga Qendra Kadastrale për Pronat e Paluajtshme në Lipjan, Komuna Kadastrale: Krajiste’, me datë 23 prill 1996. Në këtë fletë thuhet se ‘S. V., e veja e D.’ është pronare e pronës së kërkuar.
13. AKP-ja e ka verifikuar fletën poseduese. E kanë gjetur dhe e kanë verifikuar pozitivisht. AKP-ja ka bashkëngjitur në dosje një Certifikatë për të drejtat ndaj pronës së paluajtshme nga Zyra Kadastrale Komunale në Lipjan, të datës 9 prill 2008. Në atë certifikatë thuhet se S. V. është pronare/poseduese e ngastrës P-71409038-01195-0 në Gracko te Bujonca, Zona Kadastrale Kraishtë.
14. V. S., e lindur P, ka vdekur në Krushevc, në Serbi, më 14 mars 2000. Pala përgjegjëse në ankesë sipas certifikatës së martesës është djali i D dhe V. S.

Pretendimet e palëve

15. Pala ankuese ka pretenduar në ankesë se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1988 nga pronari serb Bllazha/Blaža. Ai thotë se nuk mund t’i sjell dokumentet rreth blerjes sepse shtëpia e tij është djegur gjatë luftës. Ai e bashkëngjiti një deklaratë të një dëshmitari.

Arsyetimi ligjor:

Juridiksioni

16. Gjykata Supreme e ka juridiksionin.

Pranueshmëria

17. Ankesa është e papranueshme nëse pala ankuese nuk ka marr pjesë në procedurë para AKP-së. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, **një palë** mund ta paraqesë ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i vendimit. Neni 10.2 i Rregullores parasheh: *“Çdo person, përveç paraqitësit të kërkesës [...] është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përafërta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive”*. Në këtë çështje juridike, pala ankuese nuk e ka informuar Sekretarinë ekzekutive rreth qëllimit të tij që të marr pjesë në procedurë dhe nuk jep ndonjë shpjegim për këtë veprim. Përpos kësaj , pala ankuese sipas nenit 258 paragrafit 1 dhe 2 të LPK-së, me ankesë në procedurën ankimore jo vetëm që nuk mund të marr pjesë por as edhe të kërkojë ndryshimin e padisë ngaqë kjo është ndaluar pas përfundimit të shqyrtimit të mbajtur në procedurën para KKPK-së.
18. Pala ankuese nuk i është përgjigjur urdhrin të gjykatës që të deklarojë se pse nuk ka marr pjesë në procedurë pranë KKPK-së dhe se kur dhe si e kishte pranuar informatën rreth vendimit të KKPK-së. Edhe në njoftimin e ankesës ai nuk dha asnjë deklaram rreth kësaj. Prandaj Gjykata Supreme nuk mund të konkludojë se mos pjesëmarrja e tij në procedurë pranë AKP-së mund të arsyetohet. Për këtë arsye ankesa është e papranueshme.
19. Rrjedhimisht , sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nën par. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 ,duke hedhur ankesën si të palejueshme ,është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë juridike

20. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini , Gjyqtar

Urs Nufer , Referenti i EULEX-it